

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Zjarret e lirisë" ndizen në Prishtinë, qytetarët presin verdiktin për ish-krerët e UÇK-së - Euronews Albani a
ADRESA	https://euronews.al/zjarret-e-lirise-ndizen-ne-prishtine-qytetaret-presin-verdiktin-per- ish-kreret-e-uck-se/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 20:31:37 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 20:30:39 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e34c8364cd5b93a2a9e19e1ef980857e24df593e91093e46c64b64c0a95c72a0
TEKSTI	337d0dbb007cbaf0581e2c592a22ad1c8445296028965a5fe10139f555e04f1e
PAMJA	f1fa13e5d2dca3eb774e286f183470b8119ac1d742cecb519ad6aac9dd3e807e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0241c823bb54b8428073308e457e55db0abfd8cd2a9c123e942b1de0ac1ec119
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9dbe3bb033f14c903d871b5f44056dbb0c7543241b7df3ea5dc415a83f1a9da2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/0241c823bb54b8428073308e457e55db0abfd8cd2a9c123e942b1de0ac1ec119

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Kosova Gjyqi i UÇK Edi Rama Erion Veliaj Donald Trump

KOSOVË | LAJM KRYESOR

“Zjarret e lirisë” ndizen në Prishtinë, qytetarët presin verdiktin për ish-krerët e UÇK-së



15 Shtator 2026 | 22:30

Gazetari i Euronews në Kosovë, Xhemajl Rexha, raportoi për emisionin “Now me Erla Mëhillin” nga sheshi “Skënderbej” në qendër të Prishtinës, 12 orë para vendimit në Hagë, ku qytetarët janë mbledhur në atë që është pagëzuar si “Nata e Pritjes”.

Në shesh janë mbledhur një numër i madh qytetarësh, veteranë të luftës, familjarë të dëshmorëve dhe të ish-krerëve të UÇK-së që ndodhen në Hagë, si dhe përfaqësues politikë të PDK-së. Ata kanë ndezur “zjarret e lirisë” dhe pritet të qëndrojnë në shesh, në pritje të verdiktit që pritet të shpallet nesër në orën 10:00.

Ndërkohë, edhe në Skënderaj, në zemër të Drenicës dhe vendlindjen e Hashim Thaçit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, janë mbledhur qytetarë për të pritur vendimin.

Gazetari tha se në Kosovë mbizotëron një atmosferë ankthi, pritjeje dhe pasigurie për verdiktin, por edhe për atë që mund të ndodhë më pas.

LAJMI I FUNDIT

22:13 Sadushi dhe Papajorgji në Romë, Mattarella konfirmon pjesëmarrjen në kongresin e drejtësisë në Tiranë

22:06 ‘Ish-krerët e UÇK-së meritojnë pafajësinë’, Berisha: Nesër, sytë e shqiptarëve drejt Hagës

21:56 Rama drejt SHBA-së për Asamblenë e OKB-së, takime dhe me komunitetin shqiptar në Amerikë

SHPËRNDAJE

ARTIKULLIN

21:54 “U bë gjysh katër herë”, djali i Jakup Krasniqit flet nga Haga: Nesër presim pafajësi

21:31 Gazetari tregon çfarë pritet pas vendimit të Gjykatës së Lartë: Ky ishte treni i fundit për Veliajn

21:24 “Nuk prisja që Veliaj të dilte nga burgu”, Iljazaj: Ka ndjekur një strategji të gabuar

TESTIM

“Një numër i madh qytetarësh janë mbledhur këtu në këtë shesh, aty ku u mbajt edhe ‘Marshi për Lirinë’ për ish-krerët e UÇK-së. Janë mbledhur në atë që quhet ‘Nata e Pritjes’. Aftu si në Harë, edhe në Prishtinë do të ketë një natë pritjeje, me gjacë deri në mesnatë

Ka zjarre të ndezura, janë 'zjarret e lirisë', siç janë quajtur. Një numër veteranësh të luftës, politikanë të PDK-së, familjarë dëshmorësh dhe familjarë të atyre që janë në Hagë janë mbledhur me flamuj të UÇK-së dhe qëndrojnë këtu, duke pritur me shpresë për të parë në orën 10:00 verdiktin. Po ashtu, edhe në Skënderaj, që është zemra e Drenicës, vendlindja e Hashim Thaçit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, ka një numër të madh njerëzish që janë mbledhur dhe do të qëndrojnë sonte për të pritur verdiktin. Në pritje të këtij vendimi, janë orë ankthi për të gjithë qytetarët e Kosovës, një ndjenjë pritjeje dhe pasigurie se çfarë mund të ndodhë. Bindja e shumicës është se askush nuk e di verdiktin final dhe ka pasiguri se çfarë do të ndodhë edhe më pas, cili do të jetë fati i katër ish-krerëve të UÇK-së dhe çfarë do të ndodhë më pas në Kosovë", tha ai.





Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | KOSOVË

'Ish-krerët e UÇK-së meritojnë pafajësinë', Berisha: Nesër, sytë e shqiptarëve drejt Hagës

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha ka reaguar në prag të vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë për ish-krerët e UÇK-së. Berisha shprehet se pret...

22:06 | 15/09/2026

KOSOVË | LAJM KRYESOR | LAJMI I FUNDIT | NOW ME ERLA MËHILLIN | RAJONI

"U bë gjysh katër herë", djali i Jakup Krasniqit flet nga Haga: Nesër presim pafajësi

Në një lidhje nga Haga për emisionin "Now me Erla Mëhillin", gazetarja e Euronews, Esmeralda Mualaj, mori një intervistë me djalë të Jakup Krasniqit, Altin...

21:54 | 15/09/2026

AKTUALITET | KOSOVË

"Policia masa për të ndaluar grumbullimet para gjykatës", gazetarja e Euronews raporton nga Haga

Qytetarë shqiptarë nga Kosova, Shqipëria, vende të ndryshme të Evropës, si dhe nga diaspora më e gjerë, janë mbledhur në Hagë në pritje të vendimit...

20:15 | 15/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni
Punësimi

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.